



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT
(Përfundimtar)

PËR

MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

Tiranë, Korrik 2019

RAPORT

Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes dhe të Vendimit nr. 98, datë 3.12.2018, “*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit*”, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në institucionin Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, është institucion i krijuar me Vendimin nr. 46, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave*”, ku në pikën 1, të tij, e përcakton si, *institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe si mision të tij, garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, pyjeve dhe ujërave.*

Ky vendim ka dalë në zbatim të nenit 11, pika 1, të ligjit nr.10433, datë 16.6.2011, “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”, ku përcaktohet se, *inspektorati shtetëror kompetent për kryerjen e një funksioni inspektimi të parashikuar me ligj, krijohet apo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.*

Vendimi i mësipërm, është shfuqizuar me Vendimin nr. 103, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit Pyjeve*”, i cili, ka pësuar disa herë ndryshime, duke sjellë ndryshime në misionin e këtij institucioni.

Në rastin konkret, me anë të këtij vendimi, funksioni i inspektimit të ujërave i ka kaluar Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe më pas, me Vendimin nr. 659, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “*Për disa ndryshime në vendimin nr. 103, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave...*”, ky funksion i kalon përsëri Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve.

Së fundi, me Vendimin nr. 338, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.103, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, këtij institucioni, i ka kaluar edhe funksioni i inspektimit për kundërvajtjet administrative në fushën e turizmit, duke përcaktuar varësinë e tij nga ministria që mbulon fushën e turizmit dhe mjedisit. Pra, në rastin konkret, ky institucion është në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Sipas pikës 1 dhe 2, të Kreut III, të Vendimit nr. 103, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit Pyjeve”, i ndryshuar, institucioni i mbikëqyrur, është i organizuar në nivel qendror dhe rajonal, duke përfshirë Inspektoratin Qendër dhe 12 Degë Rajonale dhe drejtohet nga Kryeinspektori, i cili është titullari i institucionit.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, përfshihet për herë të parë në skemën e administrimit të shërbimit civil. Përfshirja e tij në “Listën e institucioneve të administratës shtetërore” që hynë në fushën e shërbimit civil, është e parashikuar në mënyrë të shprehur në Lidhjen nr. 1 (numri rendor 57), të Vendimit nr.142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar.

Procesi i mbikëqyrjes në këtë institucion, filloi në datën 11.12.2018, në zbatim të Programit të Mbikëqyrjes nr. 877/1 prot., datë 3.12.2018, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar institucionit me shkresën nr. 877/2 prot., datë 3.12.2018, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit”.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha institutet e ligjit për nëpunësin civil, gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës, i përbërë nga inspektorët Aida Dobjani, Valentina Kolleshi dhe Matilda Idrizaj, nën drejtimin e Drejtorit të Mbikëqyrjes, Altin Shumeli, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit.

Ky material, u dërgua për njohje, me shkresën nr. 1126 prot., datë 24.6.2019 pranë institucionit, duke i lënë 15 ditë kohë për të paraqitur observacionet e tyre në lidhje me gjetjet e grupit të punës.

Pas kësaj, me shkresën nr. 6420 prot., datë 17.7.2019, institucioni ka dërguar të nënshkruar projektraportin së bashku me observacionet përkatëse, i cili është administruar në dosjen e mbikëqyrjes.

Qëllimi i mbikëqyrjes:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para njësisë përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil dhe titullarit të institucionit, konstatimet dhe faktet e evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi dhe shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil.
- Paralajmërimin e institucionit dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Objekti i mbikëqyrjes:

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
 - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549, dt.11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit Civil*”, apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit;
 - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune;
 - Rastet e refuzimit të deklaramit të statusit të nëpunësit civil;
 - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklaramit të statusit të punësimit të punonjësve;

- Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.
3. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës.
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës.
 4. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
 5. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
 6. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*detyrimet e nëpunësit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
 7. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit*).
 8. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.
 9. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (*kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të Përhershëm*).
 10. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues*).

11. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirit nga shërbimi civil: si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.
12. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (*njësia përgjegjëse*), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Metodologjia e mbikëqyrjes:

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin e dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në arkivën e institucionit, si dhe në sektorin e shërbimeve mbështetëse, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim dhe bashkëbisedim me Kryeinspektorin e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, *****, gjatë të cilit u diskutua mbi objektin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej të vihej në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për verifikim.
- U verifikuan pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës aktuale të institucionit, e cila ka qenë në fuqi edhe në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.
- U verifikuan procedurat e rekrutimit dhe përmbajtja e dosjeve individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër e kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.
- U verifikuan përshkrimet e punës për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, nëse ato janë të hartuara në përputhje me formatin standard të miratuar.
- U verifikuan formularët e vlerësimit të punës në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civilë të institucionit, dhe, nëse ky proces, është kryer sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.
- U verifikuan të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera në lidhje me marrëdhëniet e punës, të çdo nëpunësi, për të provuar përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës, si arsimi, përvoja në punë e të tjera.

Konstatimet janë të materializuara si tabela më vete (*Tabela 1 dhe Tabela 2*), të cilat janë pjesë e këtij raporti.

- I. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.**

1. Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit është institucion që përfshihet për herë të parë në shërbimin civil. Miratimi i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ka sjellë ndryshime për regjimin e administrimit të burimeve njerëzore në këtë institucion, duke e renditur në skemën e shërbimit civil. Mënyra e administrimit të shërbimit civil, për të gjitha institucionet që hynë në fushën e veprimit të ligjit të ri për nëpunësin civil, është e përcaktuar në nenin 2, të këtij ligji, ku parashikohet në mënyrë të shprehur se, fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore.

Administrimi i shërbimit civil në këtë institucion, bëhet mbi bazën e strukturave organizative të miratuara nga Kryeministri, në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ku, në Kreun III, neni 11, pika 3, të tij, përcakton: “Struktura dhe organika e inspektorateve shtetërore miratohet nga Kryeministri”.

Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, institucioni funksionon mbi bazën e strukturës organizative të miratuar me Urdhërin nr. 120, datë 31.7.2018, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit”, sipas së cilës, organizohet në nivel qendror nga Inspektorati Qendër dhe në nivel rajonal nga Degët Rajonale: Tiranë, Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër, Vlorë. Organika dhe numri i punonjësve, janë të miratuara nga Kryeministri, për inspektoratin qendër dhe për çdo degë rajonale.

Për kryerjen e funksioneve administrative, struktura organizative, ka gjithsej **474** pozicione pune të miratuara si më poshtë:

- **229** pozicione pune janë **pjesë e shërbimit civil**;
- **245** pozicione pune janë **punonjës administrativë**, që kryejnë veprimtari administrative, sekretarie, mirëmbajtjeje dhe shërbimi, si dhe policia pyjore.

Nisur nga përmbajtja e strukturës, konstatohet se, ajo është e organizuar mbi bazën e strukturës organizative hierarkike, të përcaktuar në ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, Kreu III, “Organizimi i brendshëm i institucioneve të administratës shtetërore”, Seksioni 2, “Institucionet e varësisë”, ku përcaktohet organizimi i brendshëm i institucioneve të varësisë.

Në rastin konkret, struktura e administratës së Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, është e organizuar në nivel drejtorie dhe sektori në qendër, ndërsa degët rajonale janë organizuar në nivel sektori. Konstatohet se, në përcaktimin e numrit të punonjësve për çdo drejtori dhe sektor, institucioni është orientuar në përcaktimet e Vendimit nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, i cili ka dalë në mbështetje të ligjit për organizimin e administratës shtetërore. Në rastin konkret, janë mbajtur parasysh orientimet e pikës 22 dhe 23, të aktit nënligjor të cituar më sipër, pasi, drejtoritë kanë në përbërje të tyre të paktën dy sektorë ndërsa, sektorët si njësi organizative e veçantë, kanë në përbërje të tyre të paktën një pozicion përgjegjës sektori dhe dy vartës.

Evidentojmë faktin se, “Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Komunikimeve”, paraqitet si njësi e burimeve njerëzore të institucionit, e cila, në nenin 10, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, është përkufizuar si, përgjegjëse për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit. Ndërsa, sipas përcaktimeve në nenin 4, pika 1, shkronja “F”, të ligjit, Departamenti i Administratës Publike, paraqitet si njësi përgjegjëse në administrimin e shërbimit civil të institucionit Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit.

Në rastin konkret, **229** pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur, paraqiten në këtë raport:

- **1** pozicion pune, ose rreth **1 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, i përket pozicionit “Kryeinspektor”.
- **5** pozicione pune, ose rreth **2 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, i përkasin pozicionit “Drejtor drejtorie”;
- **38** pozicione pune ose rreth **17 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, i përkasin pozicionit “Përgjegjës Sektori” (nga të cilat **9** pozicione pune “Përgjegjës Sektori” në Inspektoratin Qendër, ndërsa **29** pozicione pune “Përgjegjës Sektori” dhe “Kryeinspektor” në degët rajonale).
- **185** pozicione pune, ose rreth **80 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, i përkasin pozicionit “Inspektor/Specialist”.

Klasifikimi i pozicioneve në shërbimin civil, në kategorinë e lartë drejtuese, të mesme drejtuese, të ulët drejtuese dhe ekzekutive, bëhet mbi bazën e përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në mbështetje të kësaj dispozite, ka dalë Vendimi nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, ku në pikën 5, të Kreut II, ka përcaktuar klasat e zbatueshme për secilën kategori të shërbimit civil, si dhe emërtesën e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë.

Nisur nga analiza e organikës së miratuar me Urdhrin nr. 120, datë 31.7.2018, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit”, konstatohet se, pozicioni i punës, “Përgjegjës Sektori”, në degët rajonale, ka kategorinë e pagës IV-a, i cili nuk i përgjigjet kategorisë me të njëjtën emërtesë, të parashikuar në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në këto rrethana, Departamenti i Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse, duhet të unifikojë kategorizimin e këtij rasti, referuar rregullave të parashikuara në nenin 19, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në kuptim të përcaktimit të kategorisë: e lartë drejtuese, e mesme drejtuese, e ulët drejtuese dhe ekzekutive.

Konstatohet se, institucioni funksionon mbi bazën e Rregullores së Brendshme, të miratuar nga Kryeinspektori me Vendimin nr. 2, datë 18.7.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve në nivel qendror dhe rajonal”, në të cilën, janë përcaktuar rregullat për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të institucionit, si dhe janë evidentuar përgjegjësitë dhe detyrat kryesore që duhet të përmbushë çdo drejtori dhe sektor në qendër dhe në nivel rajonal, në përputhje me rolin dhe misionin e tij.

Vlerësojmë se, në rregulloren e brendshme, janë pasqyruar ndryshimet që kanë ndodhur për shkak të përfshirjes së institucionit në fushën e veprimit të ligjit të shërbimit civil. Pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, kanë të evidentuar edhe detyrat specifike që duhet të kryejë secili prej tyre, në përputhje me parimet dhe rregullat e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Ndërkohë, për shkak të ndryshimit të strukturës dhe të riorganizimit të ndodhur në vitin 2018, institucioni po punon për hartimin e rregullores së re, projekti i së cilës akoma nuk ka përfunduar.

2. Mënyra e plotësimit të pozicioneve të shërbimit civil në momentin e realizimit të mbikëqyrjes.

Nga kontrolli i ushtruar si dhe nga materialet që na janë vënë në dispozicion, mënyra e plotësimit të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil në momentin e realizimit të mbikëqyrjes dhe pjesa që zënë në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, rezulton si më poshtë:

- 91 pozicione pune, që zënë rreth **39 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë të plotësuara nga nëpunës, të cilët data 26.2.2014, që është edhe momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, i ka gjetur në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Konstatohet se,

- në **8** raste, kohëzgjatja e periudhës së punësimit në të njëjtin vend pune, ka qenë më e madhe se 1 vit;
- në **83** raste, kohëzgjatja e periudhës së punësimit në të njëjtin vend pune, ka qenë më e vogël se 1 vit.
- 82 pozicione pune, që zënë rreth **36 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar në përputhje me procedurat e përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, (**13 pozicione pune janë plotësuar nëpërmjet konkurrimit të hapur; 7 pozicione pune janë plotësuar nëpërmjet ngritjes në detyrë; 60 pozicione pune janë plotësuar nëpërmjet transferimit për shkak ristrukturimi dhe 2 pozicione pune janë plotësuar nëpërmjet transferimit të përkohshëm**).
- 1 pozicion pune, që zë rreth **1 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil dhe që i përket pozicionit Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, është plotësuar me akt emërimi të përkohshëm pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
- 55 pozicione pune, që zënë rreth **24 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë vende të lira (**5 pozicione pune “Drejtor”, 12 pozicione pune “Kryeinspektor në Degët Rajonale”, 3 pozicione pune “Përgjegjës Sektori” në Inspektoratin Qendër, 4 pozicione pune “Përgjegjës Sektori” në Degët Rajonale, 5 pozicione pune “Inspektor/Specialist” në Inspektoratin Qendër, 26 pozicione pune “Inspektor/Specialist” në Degët Rajonale**).

3. Si është kuptuar dhe zbatuar neni 67 i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Një aspekt i rëndësishëm i procesit të mbikëqyrjes është edhe verifikimi i plotësisimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, të cilët kanë qenë në marrëdhënie pune me pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, është institucion që futet për herë të parë në shërbimin civil, dhe në këto kushte, deklarimi si nëpunës civil ekzistues për çdo punonjës të këtij institucioni, duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur kohëzgjatja e marrëdhënies së punës, nga momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, për të përcaktuar kategorinë si nëpunës civil (më shumë se 1 vit), apo nëpunës civil në periudhë prove (më pak se një vit), si dhe organi që realizon deklarinimin e statusit të punësimit (*njësia përgjegjëse*).

Ky proces rregullohet në mënyrë të hollësishme edhe me Vendimin nr. 116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, Kreu III, “Statusi i punonjësve ekzistues në institucionet e administratës shtetërore dhe komunat”, pika 1 dhe 2, të ndryshuar.

Dispozitat e sipërpërmendura, përbëjnë kuadrin ligjor të zbatueshëm për deklarinimin e statusit të punësimit, pas verifikimit të procedurës së punësimit për gjithë nëpunësit që mbanin pozicione pune të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Mbështetur në këtë bazë ligjore, për të arritur në një konkluzion të saktë nëse janë zbatuar kërkesat e ligjit për deklarinimin e statusit të punësimit, u verifikuan dhe u analizuan të gjitha materialet shkruese që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, të cilat janë materializuar në Tabelat 1 dhe 2, që janë pjesë e këtij materiali.

Pas analizës së të dhënave, rezulton se, Departamenti i Administratës Publike, si njësi përgjegjëse në këtë rast, në zbatim të akteve ligjore të cituara më sipër në material, pas marrjes së dokumentacionit nga institucioni i mbikëqyrur, për çdo punonjës të punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, ka vijuar procedurat e deklarinimit të statusit të punësimit sipas kërkesave të nenit 67, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Ky proces, ka përfunduar në muajin Tetor 2014.

Nisur nga analiza që i është bërë akteve të emërimit, ku përfshihet momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, rezulton se, në **91 raste**, pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, janë emëruar punonjës, të cilët, data 26.2.2014, që është edhe momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, i ka gjetur në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit, mbështetur në përmbajtjen e pikës 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit, konstatohet se:

- Në **8 raste**, punonjësit ekzistues, kanë një periudhë *më tepër se 1 vit*, nga momenti që kanë filluar efektet juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, që e kryejnë detyrën e tyre funksionale në pozicione pune pjesë të shërbimit civil.

Për këtë kategori nëpunësish, konstatohet se, njësia përgjegjëse (DAP), ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, si “*nëpunës civilë*”.

- Në **82 raste**, punonjësit ekzistues, kanë një periudhë *më pak se 1 vit*, nga momenti që kanë filluar efektet juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, që e kryejnë detyrën e tyre funksionale në pozicione pune pjesë të shërbimit civil.

Për këtë kategori nëpunësish, konstatohet se, njësia përgjegjëse (DAP), ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, si “*nëpunës civilë në periudhë prove*”. Periudha e provës ka filluar në datën e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pra, në datën 26.2.2014.

Përmbushja e kërkesave ligjore dhe procedura e vendimarrjes në përfundim të periudhës së provës, do të analizohet në kreun V, të projektraportit, “*Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës*”.

Konkluzion: Nga sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, Departamenti i Administratës Publike, si njësia përgjegjëse, për momentin e çertifikimit të statusit të punësimit, ka vepruar drejt, në zbatim të kërkesave të ligjit.

- Në **1 rast**, njësia përgjegjëse (DAP), nuk ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit.

Bëhet fjalë për punonjësin Rexhep Koka, i cili, me aktin nr.1249, datë 21.2.2014, të Ministrit të Mjedisit, është emëruar në pozicionin *Specialist (finance)*, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, Dega Rajonale Dibër, pranë ISHMPUT, detyrë të cilën vazhdon ta kryejë edhe aktualisht.

Në lidhje me këtë rast, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, do të shprehet në mënyrë të veçantë, bazuar edhe në kërkesën e bërë nga Departamenti i Administratës Publike, i cili, nëpërmjet shkresës nr. 2074 prot., datë 9.4.2019, kërkon ndihmë administrative për zgjidhjen e rastit në fjalë.

II. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, u verifikua respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës, të përcaktuara me hollësi në Vendimin nr.142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 2, datë 7.4.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil*”, i cili është shfuqizuar me Udhëzimin nr.1, datë 31.5.2017, të DAP, “*Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil*”, por që ka qenë i zbatueshëm në momentin e hartimit të përshkrimeve të punës.

Këto akte nënligjore, të cilat kanë dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në përmbajtjen e tyre, kanë përcaktuar rastet kur një institucion pjesë e shërbimit civil, duhet të hartojë përshkrimet e punës, procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen gjatë procesit të hartimit të përshkrimeve të punës për pozicionet e shërbimit civil, nëpunësit dhe strukturat përgjegjëse për hartimin e tyre, si dhe organin që ka kompetencën për të bërë miratimin e tyre, dhe po ashtu, vazhdimësinë e procesit, me depozitimin e tyre pranë Departamentit të Administratës Publike si njësi përgjegjëse për këtë institucion.

Në pikën 14, të Kreut IV, “*Procedura dhe formati i përshkrimit të punës*”, të VKM-së nr.142, datë 12.3.2014, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni*”.

Në rastin konkret, në institucionin e mbikëqyrur, konstatohet se, momenti që ka diktuar nevojën e hartimit të përshkrimeve të punës, ka qenë *së pari*, përfshirja e institucionit për herë të parë në shërbimin civil dhe *së dyti*, ndryshimi i mënyrës së organizimit të institucionit (*për shkak të ndryshimit të mënyrës së organizimit, institucioni ka kaluar disa herë në proces ristrukturimi*).

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të legjislacionit të ri të shërbimit civil, ISHMPUT, si institucion i administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil, duhet të hartonte përshkrimet e punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, sipas afateve të përcaktuara në aktin nënligjor.

Nga ana tjetër, për shkak të ndryshimit të mënyrës së organizimit, institucioni ka kaluar disa herë në proces ristrukturimi. Ky moment, dikton nevojën e hartimit të përshkrimeve të reja të punës në përputhje me misionin, detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të pozicionit respektiv të punës në kushtet e riorganizimit.

Nga verifikimet në subjekt, u konstatua se, në asnjë rast, procesi i hartimit të përshkrimeve të punës nuk është kryer, megjithëse, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, u pretendua se, ky proces ka filluar dhe se, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, si organi nga i cili varen, po hartohen përshkrimet e punës për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil.

Vemë në dukje se, hartimi i përshkrimeve të punës ka një rëndësi të veçantë në mirëadministrimin e shërbimit civil dhe në funksionimin normal të institucionit, për arsye se është pikërisht ky akt që përcakton në mënyrë të detajuar funksionet konkrete që do të kryejë çdo nëpunës. Gjithashtu, në këtë akt, përcaktohet edhe shkalla e përgjegjësisë, natyra e punës, mjedisi menaxherial, shkalla e vendimmarrjes dhe përcaktime të tjera, të cilat janë të rëndësishme të njihen nga punonjësi, i cili mbulon një pozicion pune pjesë të shërbimit civil.

Hartimi i përshkrimeve të punës, është i rëndësishëm edhe në zbatimin normal të procedurave të tjera që kërkohen nga ligji për nëpunësin civil, të tilla si, procedura për vlerësimin e arritjeve në punë apo ecuritë disiplinore. Këto procedura nuk mund të realizohen normalisht në momentin kur nëpunësit nuk i janë përcaktuar në mënyrë të detajuar detyrat dhe përgjegjësitë që ai ka.

Konkluzion: Nga sa më sipër, për të rregulluar ligjshmërinë në këtë rast, njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, në bashkëpunim me njësinë e burimeve njerëzore të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, si dhe Departamentin e Administratës Publike, duhet të veprë si më poshtë:

- Të përfundojë hartimin e përshkrimeve të punës për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, dhe lidhjeve të cilat janë pjesë e këtij vendimi. Këto akte nënligjore, në përmbajtjen e tyre kanë përcaktuar procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen për hartimin e përshkrimeve të punës, nëpunësit përgjegjës për hartimin e tyre, strukturën përgjegjëse për vlerësimin e bazueshmërisë së tyre në ligjin specifik dhe formatin e miratuar, organin që ka kompetencën për miratimin e tyre, si dhe detyrimin për depozitimin pranë njësisë përgjegjëse.
- Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, (*Spektori i Burimeve Njerëzore dhe Komunikimeve*), në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit

respektiv të punës, të mbledhë informacionin e nevojshëm për çdo pozicion pune dhe pas një analize të këtij informacioni, të përcaktohen në mënyrë të qartë detyrat, përgjegjësitë dhe kërkesat e veçanta për çdo pozicion apo grup pozicionesh të shërbimit civil.

- Formati i përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil, të jetë sipas lidhjes 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, ku janë të përfshirë të gjithë elementet, sipas modelit standard të hartuar nga Departamenti i Administratës Publike, si dhe të dhënat për pozicionin e punës, misioni, qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës, detyrat kryesore, përgjegjësitë kryesore, zgjidhja e problemeve, vendimmarrja, mjedisi menaxherial, mbikëqyrja, stafi në varësi, kushtet e punës dhe kërkesat e posaçme.
- Në ndarjen *“Kërkesat e posaçme”*, të plotësohen në mënyrë të qartë kërkesat e posaçme që duhet të plotësojë nëpunësi për nivelin e arsimit (*niveli i diplomës “Bachelor”, “Master Profesional”, “Master i Shkencave” që ai/ajo duhet të zotërojë*); profili i arsimit të lartë; kualifikimet/trajnimet dhe kërkesa të tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës të shërbimit civil.
- Të kërkojë nga njësia përgjegjëse, (DAP), që të japë mendimin me shkrim, lidhur me përshkrimet e punës, nëse janë të hartuara në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.
- Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse, përshkrimet e punës t’i përcillen për miratim Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë së linjës, i cili finalizon këtë proces duke nënshkruar përshkrimet e punës në ndarjen përkatëse, pasi nënshkrimi i formularit të përshkrimit të punës nga ana e tij, nga eprori direkt dhe nëpunësi civil për të cilin është hartuar përshkrimi i punës, është një detyrim specifik, i parashikuar në pikën 18, 19 dhe 20 të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar.
- Në përfundim të procedurave si më sipër, një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara, të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike. Kjo për faktin pasi, vetë akti nënligjor, i ka konceptuar këto akte me karakter të qëndrueshëm që hartohen kur krijohen institucione të reja dhe që kushti për t’u ndryshuar është ndryshimi i mënyrës së organizimit të institucionit apo ndryshimi i legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni.

Nisur nga observacionet që subjekti i mbikëqyrur ka paraqitur në lidhje me këtë pikë të projektraportit, Komisioneri vëren se, nga ana e institucionit, është pretenduar se, janë hartuar përshkrimet e punës për punonjësit e qendrës dhe të degëve rajonale, si dhe i ka hedhur ato në sistemin HRMIS. Ndërkohë, ky pretendim nuk provohet, pasi, nuk ka akte shkresore për të vërtetuar përfundimin e këtij procesi sipas rekomandimeve të lëna në projektraport.

Për këtë arsye, Komisioneri çmon se, verifikimi i përfundimit të procesit të hartimit të përshkrimeve të punës, sipas pretendimeve të institucionit, do të jetë objekt i verifikimit të mëtejshëm, në vijim të procesit të mbikëqyrjes në këtë institucion, lidhur me realizimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

III. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimi në shërbimin civil.

Administrimi i shërbimit civil për të gjithë institucionet e administratës shtetërore bazohet në planin vjetor të pranimi në shërbimin civil, në zbatim në pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil”.

Në rastin konkret, në lidhje me nevojat për rekrutim në shërbimin civil në këtë institucion, për vitin 2018, është komunikuar në mënyrë elektronike me njësinë e burimeve njerëzore të Ministrisë së linjës, si institucioni nga i cili varen dhe Departamentin e Administratës Publike. Konstatohet se, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, në planifikimin e nevojave për rekrutim, ka parashikuar plotësimin e 47 vendeve të lira, të cilat i përkasin pozicioneve si më poshtë:

- 1 pozicion pune “Kryeinspektor” i ISHMPUT;
- 12 pozicione pune “Kryeinspektor” në Degët Rajonale;
- 5 pozicione pune “Drejtor” në Inspektoratin Qendër;
- 3 pozicione pune “Përgjegjës Sektori” në Inspektoratin Qendër;
- 2 pozicione pune “Inspektor”, në Inspektoratin Qendër;
- 4 pozicione pune “Përgjegjës Sektori” në Degët Rajonale;
- 20 pozicione pune “Inspektor/Specialist”, në Degët Rajonale.

Nga verifikimi rezulton se, në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, nuk ka përfunduar asnjë procedurë konkurrimi, nga ato të shpallura si më sipër.

Konstatim

Në këtë moment të analizës, evidentojmë faktin se, në kushtet kur pozicionet e lira nuk janë plotësuar për një kohë të gjatë, në disa prej tyre, me qëllim organizimin, mbarëvajtjen dhe

vijueshmërinë e punës, disa punonjësve, të cilët kryejnë detyra të caktuara në institucion (*pothuajse në të gjitha rastet janë punonjës të Sektorit të Policisë Pyjore*), u është ngarkuar si detyrë shtesë që të ushtrojnë përkohësisht detyrën “Kryeinspektor”, në Degët Rajonale të ISHMPUT.

Komisioneri vëren se, kjo mënyrë e dhënies së detyrave “shtesë”, nuk njihet nga legjislacioni i shërbimit civil, pasi, ky moment, është rregulluar nga pika 1 e nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe pika 2 e Kreut I, të Vendimit nr. 125 dt. 17.2.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”. Këto dispozita parashikojnë se, në rastet kur paraqiten nevoja të tilla, do të plotësohen vetëm nëpërmjet transferimit të përkohshëm, deri në 6 muaj me/ose pa ndërprerje, gjatë dy viteve, brenda dhe në interes të institucionit, me kusht ruajtjen e kategorisë së nëpunësit. Pra, edhe transferimi i përkohshëm (*pasi në ligj nuk bëhet fjalë për “ngarkim me detyra të përkohshme”*) i nëpunësve me një nivel më të ulët kategorie, për të kryer detyra të një niveli më të lartë, siç është në rastin konkret pozicioni “Kryeinspektor” (*i kategorisë së ulët drejtuese*), nuk lejohet, pasi prezumohet që nëpunësi nuk ka formimin, kualifikimin dhe eksperiencën e nevojshme, për të kryer një detyrë të tillë.

Nga ana tjetër, nisur edhe nga rëndësia dhe detyrat e Kryeinspektorit në Degët Rajonale (*të cilat janë përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit*), mosplotësimi i këtij pozicioni pune për një kohë të gjatë dhe mosfiksionimi i tij, krijon një shkëputje në zinxhirin e hierarkisë organizative, duke vështirësuar në këtë mënyrë, veprimtarinë e përditshme të institucionit, i cili, ka vendosur ta zgjidhë këtë situatë me dhënien e detyrave shtesë punonjësve ekzistues, në kundërshtim me ligjin.

Në këto kushte, vërejmë se, aktet administrative të nxjerra nga Kryeinspektori, të cilat do t'i rendisim më poshtë, të anulohen prej tij dhe të merren masa, duke kërkuar nga Departamenti i Administratës Publike, plotësimin e pozicioneve në raste të tilla me transferime të përkohshme, sipas parashikimeve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Bëhet fjalë për aktet si më poshtë:

1. Urdhër nr.94, datë 16.3.2018, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, Dega Rajonale Tiranë, punonjësin ******, me detyrë “Inspektor”, në Sektorin e Policisë Pyjore, Dega Rajonale Tiranë.
2. Urdhër nr.454, datë 6.12.2018, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, Dega Rajonale Durrës, punonjësin ******, me detyrë “Përgjegjës Sektori”, Sektori Operacional i Inspektimit të Policisë Pyjore, në Drejtorinë e Inspektoratit të Policisë Pyjore, pranë ISHMPUT, nivel qendror.
3. Urdhër nr.336, datë 13.8.2018, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, Dega Rajonale Gjirokastrë, punonjësin

*****, me detyrë “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Policisë Pyjore Tepelenë, Dega Rajonale Gjirokastrë.

4. Urdhër nr.60, datë 5.3.2019, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, Dega Rajonale Lezhë, punonjësin *****, me detyrë “Përgjegjës Sektori”, Sektori Lezhë, në Sektorin e Policisë Pyjore, Dega Rajonale Lezhë.
5. Urdhër nr.85, datë 18.3.2019, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, Dega Rajonale Shkodër, punonjësin *****, me detyrë “Inspektor”, Sektori Operacional i Inspektimit të Policisë Pyjore, në Drejtorinë e Inspektoratit të Policisë Pyjore, pranë ISHMPUT, nivel qendror.
6. Urdhër nr.213, datë 14.5.2018, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, Dega Rajonale Elbasan, punonjësin *****, me detyrë “Inspektor”, Sektori Librazhd, në Sektorin e Policisë Pyjore, Dega Rajonale Elbasan.
7. Urdhër nr.290, datë 3.7.2018, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, Dega Rajonale Korçë, punonjësin *****, me detyrë “Inspektor”, Sektori Operacional i Inspektimit të Policisë Pyjore, në Drejtorinë e Inspektoratit të Policisë Pyjore, pranë ISHMPUT, nivel qendror.
8. Urdhër nr.138, datë 17.4.2018, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, Dega Rajonale Dibër, punonjësin *****, me detyrë “Përgjegjës Sektori”, Sektori Mat, në Sektorin e Policisë Pyjore, Dega Rajonale Dibër.
9. Urdhër nr.27, datë 5.2.2019, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, Dega Rajonale Kukës, punonjësin *****, me detyrë “Përgjegjës Sektori”, Sektori Kukës, në Sektorin e Policisë Pyjore, Dega Rajonale Kukës.
10. Urdhër nr.312, datë 18.7.2018, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, Dega Rajonale Vlorë, punonjësin *****, me detyrë “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, Dega Rajonale Vlorë.
11. Urdhër nr.475, datë 24.12.2018, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, Dega Rajonale Berat, punonjësin *****, me detyrë “Inspektor”, Sektori Berat, në Sektorin e Policisë Pyjore, Dega Rajonale Berat.
12. Urdhër nr.388, datë 24.10.2018, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, Dega Rajonale Fier, punonjësin *****, me detyrë “Inspektor”, Sektori Fier, në Sektorin e Policisë Pyjore, Dega Rajonale Fier.

Përsa i përket plotësimit të pozicioneve të lira, Departamenti i Administratës Publike, duhet të fillojë procedurat për plotësimin e tyre në bazë të kërkesave të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në subjektin, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, pasi pengohet funksionimi normal i institucionit.

Në lidhje me këtë pikë të projektraportit, në observacionet e institucionit, është pretenduar se, vendet vakante për “Kryeinspektor”, në Degët Rajonale, i kanë dërguar për shpallje pranë Departamentit të Administratës Publike.

Komisioneri vëren se, nga ana e institucionit, duhet të vijojë puna për realizimin e detyrës, në lidhje me anulimin e akteve të cituara më sipër, dhe më pas, të fillojnë procedurat për plotësimin e tyre në bazë të kërkesave të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, sipas orientimeve të dhëna në këtë raport.

Përmbushja e kësaj detyre nga ana e institucionit, do të jetë objekt i verifikimit të mëtejshëm, në vijim të procesit të mbikëqyrjes në këtë institucion, lidhur me realizimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

IV. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, u verifikuan emërimet në pozicionet e shërbimit civil nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë të kryera nga data 26.2.2014, që është data e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, deri në momentin e realizimit të mbikëqyrjes.

Emërimet në pozicionet e shërbimit civil, sipas kategorive dhe pozicioneve, paraqiten si më poshtë:

- **13 pozicione të kategorisë ekzekutive janë plotësuar nëpërmjet procedurës së konkurrimit të hapur.**

Në rastin konkret, në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, nëpërmjet konkurrimit të hapur, me aktin e emërimit nga Departamenti i Administratës Publike, janë emëruar nëpunës civilë në periudhë prove, në pozicionet si më poshtë:

1. Akt nr. 6769, datë 4.11.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove ***** në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Industrisë dhe Veprimtarive Prodhuese, Drejtoria e Inspektimit Mjedisor, në Inspektoratin Qendër.
2. Akt nr. 7734, datë 7.12.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove ***** në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin Juridik dhe i Ankesave Administrative, Drejtoria Juridike, e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, në Inspektoratin Qendër.

3. Akt nr. 8219, datë 30.12.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove ***** në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Financës, Buxhetit dhe Statistikave, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Inspektoratin Qendër.
4. Akt nr. 8220, datë 30.12.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove ***** në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Financës, Buxhetit dhe Statistikave, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Inspektoratin Qendër.
5. Akt nr. 8153, datë 29.12.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove ***** në pozicionin “*Specialist IT*”, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Inspektoratin Qendër.
6. Akt nr. 8239, datë 30.12.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove ***** në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, Dega Rajonale Tiranë.
7. Akt nr. 5965, datë 27.11.2015, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove ***** në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, Dega Rajonale Elbasan.
8. Akt nr. 7737, datë 7.12.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove ***** në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, Dega Rajonale Vlorë.
9. Akt nr. 6845, datë 7.11.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove ***** në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, Dega Rajonale Korçë.
10. Akt nr. 7947/4, datë 6.1.2017, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove ***** në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, Dega Rajonale Korçë.
11. Akt nr. 6050, datë 3.12.2015, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove ***** në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, Dega Rajonale Fier.
12. Akt nr. 7736, datë 7.12.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove ***** në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, Dega Rajonale Fier.
13. Akt nr. 7743/52, datë 6.2.2017, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove ***** në pozicionin “*Specialist Finance*”, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, Dega Rajonale Lezhë.

Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, në zbatim të përcaktimeve të nenit 24, të ligjit, pas mbarimit të periudhës së provës, për këta nëpunës, ka përfunduar procedura e vendimmarrjes në fund të periudhës së provës. Më hollësisht, kjo procedurë, trajtohet në pikën e programit “*Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës*”, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve që parashikon ligji për nëpunësin civil në periudhë prove.

- 7 pozicione të kategorisë së ulët drejtuese (përgjegjës sektori), janë plotësuar nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Në këto pozicione, janë emëruar nga Departamenti i Administratës Publike, sipas akteve të emërimit përkatëse:

1. Akt nr. 4300, datë 14.9.2015, është emëruar *****, në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Inspektimit të Burimeve Natyrore, Drejtoria e Inspektimit Mjedisor, në Inspektoratin Qendër.
2. Akt nr. 4331, datë 15.9.2015, është emëruar *****, në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Inspektimit të Industrisë dhe Veprimtarive Prodhuese, Drejtoria e Inspektimit Mjedisor, në Inspektoratin Qendër.
3. Akt nr. 4596, datë 29.9.2015, është emëruar *****, në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin Juridik dhe i Ankesave Administrative, Drejtoria Juridike, e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, në Inspektoratin Qendër.
4. Akt nr. 4782, datë 27.6.2018, është emëruar *****, në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, Drejtoria Juridike, e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, në Inspektoratin Qendër.
5. Akt nr. 4402, datë 17.9.2015, është emëruar *****, në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Financës, Buxhetit dhe Statistikave, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Inspektoratin Qendër.
6. Akt nr. 7170, datë 31.10.2016, është emëruar *****, në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, Dega Rajonale Elbasan.
7. Akt nr. 6360, datë 18.10.2016, është emëruar *****, në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, Dega Rajonale Vlorë.

Në të gjitha rastet, konstatohet se, në momentin e aplikimit, të gjithë këta nëpunës kanë qenë nëpunës civilë të konfirmuar në nivelin ekzekutiv, në pozicionin “Inspektor/Specialist”. Në zbatim të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, këta nëpunës, janë emëruar në pozicionet përkatëse nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, procedurat e rekrutimit, nëpërmjet konkurrimit të hapur për 13 pozicione të kategorisë ekzekutive dhe ngritjes në detyrë për 7 pozicione të kategorisë së ulët drejtuese, janë kryer nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

V. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u verifikua përmbushja e kërkesave ligjore të periudhës së provës, të përcaktuara nga neni 24, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Kreu V, i Vendimit nr. 143, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, i

shfuqizuar, (për të gjitha ato procedura që kanë filluar gjatë kohës që ka qenë në fuqi kjo VKM), si dhe Kreun VI, i Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, në institucionin e mbikëqyrur, nga momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit, deri në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, kanë kryer periudhën e provës **95** nëpunës civilë, nga të cilët:

- **82 nëpunës civilë**, e kanë fituar këtë status për shkak të ligjit.

Në këtë kategori, përfshihen punonjës eksistues, të cilët janë cilësuar në periudhë prove, pasi, momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri, i ka gjetur këta punonjës në një pozicion pune të shërbimit civil, ku periudha e punësimit ka qenë më e vogël se një vit. Në këtë rast, periudha e provës, e cila zgjat një vit, ka filluar nga momenti i fillimit të efekteve të ligjit për nëpunësin civil, që është data 26.2.2014.

- **13 nëpunës civilë**, janë deklaruar të tillë, pasi janë rekrutuar nëpërmjet procedurës së konkurrimit të hapur në pozicione të kategorisë ekzekutive.

Në këtë kategori, përfshihen ata punonjës, të cilët janë deklaruar nëpunës civilë në periudhë prove, pas kryerjes së procedurave të konkurrimit në nivelin ekzekutiv, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Në këtë rast, periudha e provës, ka filluar nga data e aktit të emërimit.

Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, rezulton se, në të gjitha rastet, për këta punonjës, ka mbaruar periudha e provës. Në këto kushte, u verifikua përmbushja e kërkesave ligjore të periudhës së provës në bazë të të cilave, nëpunësi civil, është i detyruar që të kryejë ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), dhe të ndjekë udhëzimet e nëpunësit më të vjetër, nën kujdesin e të cilit ai është i vendosur. Ndërsa institucioni, ka detyrimin, që të përzgjedhë nëpunësin më të vjetër nën kujdesin e të cilit do të vendoset nëpunësi civil në periudhë prove, të bëjë vlerësimin e rezultateve individuale në punë, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore dhe të shprehet me vendim në përfundim të periudhës së provës. Nga këqyrja e akteve rezulton:

- në **93 raste** ka përfunduar procedura e vendimmarrjes në përfundim të periudhës së provës. Eprori direkt, ka bërë vlerësimin e rezultateve individuale në punë, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore dhe, bazuar në rezultatet e testimit në ASPA, si dhe në mendimin me shkrim të nëpunësit civil më të vjetër në detyrë, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësi civil në periudhë prove, ka vendosur konfirmimin si nëpunës civil në pozicionin përkatës të punës.

- në 2 raste, dhe konkretisht për punonjësit ***** dhe ***** (inspektorë në Degën Rajonale Korçë), megjithëse ka kaluar një afat i konsiderueshëm kohor, nuk është kryer procedura e vendimmarrjes në lidhje me periudhën e provës, por konstatohet se, këta punonjës, kanë kryer vetëm programin e trajnimit të detyrueshëm në ASPA.

Konstatohet se, në rastet ku punonjësit e kanë fituar statusin “*nëpunës civil*” për shkak të ligjit, kanë dalë aktet e konfirmimit nga eprori direkt, sikurse përcaktohet në pikën 7 dhe 12, të kreut V, “*Periudha e provës*”, të Vendimit nr.143, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, të shfuqizuar, i cili ka qenë në fuqi në momentin kur këta punonjës kanë kryer periudhën e provës.

Ndërsa në 11 rastet e tjera, vendimi i konfirmimit si “*nëpunës civil*”, i marrë nga eprori direkt, i është njoftuar edhe njësisë përgjegjëse (DAP), e cila vetëm në 5 raste, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit për secilin nëpunës. Këto veprime janë kryer në zbatim të përcaktimeve të pikës 12 dhe 13, të Vendimit nr.243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.

Në lidhje me punonjësit *****, *****, *****, *****, ***** dhe *****, të cilët janë konfirmuar nëpunës civilë nga eprori direkt në përfundim të periudhës së provës, për të rregulluar ligjshmërinë, në projektraportin dërguar institucionit, është kërkuar që njësia përgjegjëse, DAP, të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit për këta nëpunës.

Ndërkohë, në observacionet e dërguara nga institucioni, Komisioneri konstaton se, kjo detyrë është realizuar dhe bashkëlidhur janë dërguar edhe aktet e njësisë përgjegjëse DAP, për çdo nëpunës. Në këtë mënyrë, konstatimet e përmendura për parregullsi për këta nëpunës, janë rregulluar.

Konkluzion: Nga sa analizuam më sipër, Komisioneri vlerëson se, procedura e vendimmarrjes në fund të periudhës së provës është kryer në përputhje me kërkesat e ligjit.

Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, në lidhje me punonjësit ***** dhe *****, të përfundojë procedurën e vendimmarrjes në fund të periudhës së provës, duke patur parasysh në këtë rast, që të zbatohen të gjitha kërkesat që parashikon ligji për punonjësit në periudhë prove dhe pas kësaj, të shprehet për konfirmimin ose jo të tyre në pozicionet përkatëse.

a. Lirim nga shërbimi civil për shkak të moskonfirmimit

Gjatë procesit të mbikëqyrjes u konstatua 1 rast lirimi nga shërbimi civil për shkak të moskonfirmimit të punonjësit në përfundim të periudhës së provës.

Bëhet fjalë për punonjësen *****, e cila, me aktin nr.7742, datë 7.12.2016, të DAP, është emëruar *nëpunës civil në periudhë prove*, në pozicionin *Specialist në Sektorin e Burimeve*

Njerëzore dhe Komunikimit, në Drejtorinë Juridike, Prokurimit, Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, në ISHMP në Nivel Qendror.

Konstatohet se, ky emërim, fillimisht është refuzuar nga ana e institucionit për shkak të mosplotësimit të kriterit arsimor, lidhur me profilin e arsimit të kërkuar nga institucioni (shkresa derjtuar DAP me nr.8409 prot., datë 21.12.2016).

Departamenti i Administratës Publike, nëpërmjet shkresës nr.8015/1 prot., datë 9.1.2017, sqaron institucionin se, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për organizimin e procedurave të pranimit në shërbimin civil, ka vendosur unifikimin e kriterëve për grupin e pozicioneve “*Specialist të burimeve njerëzore*” në institucionet e administratës shtetërore, duke e grupuar pozicionin e sipërcituar në llojin e diplomës “*Shkenca shoqërore*”, me nivel minimal diplome “*Bachelor*”. Në kushtet kur kandidatja ***** ka plotësuar kriteret, DAP, i ka kërkuar institucionit të marrë masa për zbatimin e aktit të emërimit. Në zbatim të këtij akti, titullari i institucionit, me Urdhrin nr.19, datë 16.1.2017, ka urdhëruar fillimin e marrëdhënieve financiare për punonjësen në fjalë.

Në përfundim të periudhës së provës, është kryer procedura e vendimmarrjes, nga e cila rezulton se, kjo punonjëse, nuk është konfirmuar nëpunës civil dhe për këtë shkak, është liruar nga shërbimi civil. Në këtë përfundim është arritur mbi bazën e vlerësimit të rezultateve individuale në punë në fund të periudhës së provës, i cili rezulton të jetë në nivelin 4, “*jo kënaqshëm*”, të bërë nga eprori direkt, si dhe në mendimin me shkrim të nëpunësit civil më të vjetër në detyrë, i cili, për shkak të performancës së dobët në detyrë të kësaj punonjëseje, ka sugjeruar moskonfirmimin e saj.

Në rastin konkret, me vendimin nr.1599, datë 16.4.2018, të titullarit të institucionit, punonjësja ***** , nuk është konfirmuar nëpunës civil dhe me Urdhrin nr.140, datë 18.4.2018, ajo është liruar nga detyra. Ky lirim i është njoftuar edhe Departamentit të Administratës Publike si njësi përgjegjëse. Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, ky pozicion rezulton të jetë vend i lirë.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, procedura e vendimmarrjes në përfundim të periudhës së provës për punonjësen ***** , është kryer në përputhje me nenin 24, pika 3/c, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe me përcaktimet e Kreut VI, “*Periudha e provës*”, të Vendimit nr.243, datë 18.3.2015, Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.

VI. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste.

a. Raste të transferimit të përkohshëm.

Gjatë procesit të verifikimit, u konstatua se, për periudhën objekt mbikëqyrjeje, është realizuar procedura e transferimit të përkohshëm, si më poshtë:

- në **2 raste**, kjo procedurë është kryer brenda institucionit.

Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

1. ***** , ka filluar marrëdhënien e punës me institucionin në pozicionin *Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor*, Dega Rajonale Durrës, i emëruar në këtë detyrë me aktin nr.1096/1, datë 21.2.2014, të Ministrit të Mjedisit. Ai është deklaruar “*nëpunës civil në periudhë prove*”, me aktin nr.3301/311, datë 30.10.2014, të DAP dhe është konfirmuar “*nëpunës civil*” në pozicionin e mësipërm me aktin nr. 8377, datë 19.12.2016, të eprorit direkt.

Nga përmbajtja e akteve të administruara, rezulton se, pas ristrukturimit të institucionit në vitin 2016, me aktin nr.1577/1, datë 25.5.2016, të DAP, me propozimin e Komisionit të Ristrukturimit, ai është transferuar në pozicionin *Inspektor, Sektori Krujë, në Sektorin e Policisë Pyjore*, Dega Rajonale Durrës.

Më pas, për nevoja të institucionit, me Urdhrin nr.24, datë 30.1.2017, të Kryeinspektorit, është transferuar përkohësisht, nga pozicioni “*Inspektor në Sektorin e Policisë Pyjore*”, në pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor*”, po në Degën Rajonale Durrës, ku vazhdon të kryejë detyrën aktualisht. Me aktin nr. 455, datë 30.1.2017, ky transferim, i është njoftuar edhe Departamentit të Administratës Publike.

Nga verifikimi i mëtejshëm konstatohet se, reagimi i DAP-it, në lidhje me këtë transferim, ka ardhur nëpërmjet shkresës nr. 5415/1, datë 26.7.2018 (*me anë të së cilës i është kthyer përgjigje institucionit për informacionin e dërguar në DAP me shkresën nr. 3641, datë 13.7.2018, ndërmjet të tjerëve edhe për transferimin e punonjësit ******), ku ai sqaron: “*...ky transferim është bërë nga vetë Kryeinspektori i ISHMPUT-së, bazuar në Kreun III, të Vendimit nr. 103, datë 4.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, për nevoja të institucionit dhe nuk është kryer nga ana e DAP. Për sa më lart, në lidhje me transferimin e punonjësit ***** , bazuar në nenet 113 e në vijim, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, i takon Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, në cilësinë e organit përgjegjës për nxjerrjen e aktit, që të rikthejë në detyrën e mëparshme punonjësin, pasi transferimi është bërë me urdhër të tij*”.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, nga hetimi administrativ në lidhje me këtë rast, nisur nga përmbajtja e akteve të administruara, rezulton se, punonjësi ***** , ka fituar statusin si “*nëpunës civil*” në pozicionin *Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor*.

Për shkak të shkurtimit të vendit të tij të punës, pas riorganizimit të institucionit në vitin 2016, është transferuar në pozicionin *Inspektor i Policisë Pyjore*, i cili, nuk është pjesë e shërbimit civil.

Në rastin konkret, në bazë të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*”, i ndryshuar, në pikën 10, të nenit 2, të këtij ligji përcaktohet:

“Inspektor i Policisë Pyjore është punonjësi me arsimin përkatës pyjor, me uniformë, i armatosur, i pajisur me kartë identifikimi, që ka atributet e njohura me këtë ligj, i inspektoratit shtetëror përgjegjës për pyjet, i cili, ka për detyrë zbatimin e ligjit.....”

Në kushtet kur institucioni ka hyrë në fushën e veprimit të ligjit të ri për nëpunësin civil, mënyra e administrimit të shërbimit civil në këtë institucion, bazohet në nenin 2, të ligjit për nëpunësin civil, ku është parashikuar në mënyrë të shprehur se, “*fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore*”. Nga ana tjetër, në këtë dispozitë, përcaktohen edhe rastet përjashtimore kur nuk zbatohet ky ligj dhe bëhet fjalë për shkronjën “h”, ku parashikohet si rast i tillë “*punonjësit që sipas ligjit lejohet të mbajnë armë*”.

Në këto kushte, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, punonjësit, të cilët, sipas ligjit, lejohen të mbajnë armë, nuk përfshihen në fushën e veprimit të këtij ligji e për rrjedhojë, pozicioni i punës *Inspektor i Policisë Pyjore* në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, *nuk është pjesë e shërbimit civil*.

Në vijim të arsytimit në lidhje me transferimin e përkohshëm të punonjësit *****, në bazë të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, transferimi i nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, në një pozicion tjetër, për shkak se pozicioni i mëparshëm është shkurtuar, bëhet duke ruajtur kategorinë e nivelit të punësimit dhe brenda sistemit të shërbimit civil. Në këtë rast, nuk është respektuar kushti që, transferimi të kryhet në një pozicion tjetër të shërbimit civil, por, megjithatë, nga përmbajtja e akteve të administruara, nuk rezulton që punonjësi ***** ta ketë refuzuar pozicionin e ofruar pas ristrukturimit.

Më tej, për transferimin e tij në një pozicion pune të shërbimit civil, në këtë rast, ka vepruar titullari i institucionit, i cili, për nevoja pune, ka transferuar përkohësisht punonjësin ***** në pozicionin *Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor*. Ky veprim është kryer në kundërshtim me ligjin, pasi, emërimi i përkohshëm në një pozicion pune të shërbimit civil, në kushtet e punonjësit *****, mund të bëhej nga njësi përgjegjëse DAP, vetëm në rastin që parashikon pika 8, shkronja “b”, e nenit 50, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil, si pasojë e ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, kanë të drejtë që, brenda periudhës 2-vjeçare pas*

përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil: b) të emërohen në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil”.

Në rastin konkret, një gjë e tillë nuk ka ndodhur, pasi, megjithëse transferimi i përkohshëm është bërë brenda afatit 2-vjeçar, ky veprim është kryer në kundërshtim me ligjin, në kushtet kur ka vepruar titullari i institucionit e për rrjedhojë, është ky organ, i cili duhet të rikthejë në detyrën e mëparshme, pra, në pozicionin *Inspektor i Policisë Pyjore*, punonjës in *****. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Departamenti i Administratës Publike, i cili rezulton nëpërmjet shkresës të cituar më sipër në material drejtuar institucionit të mbikëqyrur.

Konkluzion: Komisioneri vëren se, Urdhri nr.24, datë 30.1.2017, i Kryeinspektorit, që ka kryer transferimin e përkohshëm, nga pozicioni “*Inspektor në Sektorin e Policisë Pyjore*”, në pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor*”, në Degën Rajonale Durrës, është një akt i pavlefshëm për shkak se ka dalë në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji, e për rrjedhojë, bazuar në shkronjën “a/ii”, të nenit 108, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, ai është akt administrativ, i cili, bazuar në nenin 110 të ligjit në fjalë, nuk mund të sjellë asnjë pasojë juridike. Në bazë të neneve 110, pika 2, 111 dhe 113, të ligjit si më sipër, organi publik që ka nxjerrë aktin e transferimit (*Urdhri nr. 24, datë 30.1.2017*) pra, Kryeinspektori i ISHMPUT, duhet të anulojë këtë akt dhe të urdhërojë kthimin e punonjësit në fjalë në vendin e mëparshëm të punës si *Inspektor i Policisë Pyjore*.

2. ***** , ka filluar marrëdhënien e punës me institucionin në pozicionin *Inspektor i Policisë Pyjore*, i emëruar në këtë detyrë me aktin nr.780, datë 21.2.2014, të Ministrisë të Mjedisit. Ai është deklaruar “*nëpunës civil në periudhë prove*”, me aktin nr.3301/14, datë 30.10.2014, të DAP dhe është konfirmuar si “*nëpunës civil*” në pozicionin e mësipërm me aktin nr. 6010, datë 7.9.2016, të eprorit direkt.

Nga materialet e administruara, konstatohet se, me aktin nr. 94, datë 1.4.2016, të titullarit të institucionit, është emëruar *Inspektor i Policisë Pyjore*, nga niveli qendror, në Degën Rajonale Tiranë. Nga ky pozicion pune, me aktin nr.31, datë 7.2.2017, të Kryeinspektorit, ai është transferuar përkohësisht në pozicionin *Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor*, në Degën Rajonale Tiranë, detyrë, të cilën e kryente edhe në momentin e realizimit të procesit të mbikëqyrjes.

Pas trajtimit të këtij rasti në projektraportin e mbikëqyrjes, është arritur në përfundimin se, punonjësi ***** , nuk e gëzon statusin e nëpunësit civil, pasi, ndryshimet ligjore të ndodhura gjatë periudhës së provës, e kanë ndërprerë të drejtën e tij për tu konfirmuar si nëpunës civil.

Në këtë përfundim është arritur duke arsyetuar se, pozicioni i punës *Inspektor i Policisë Pyjore* në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, nuk është pjesë e shërbimit civil (siç u analizua më sipër në material). Deklarimi i statusit të punësimit në bazë të ligjit për shërbimin civil (në datën 30.10.2014), për punonjësit e policisë pyjore, është bërë para ndryshimeve të ligjit nr.152/2013 (*shkronja “h” e dispozitës së mësipërme ka ndryshuar me ligjin nr.178/2014, i cili ka hyrë në fuqi në datën 29.1.2015*). Pas këtij momenti, institucioni nuk duhej të nxirrte aktin për konfirmimin “*nëpunës civil*”, të punonjësit *****, në pozicionin *Inspektor i Policisë Pyjore*, pasi, punonjësit e punësuar në këto pozicione, nuk mund të trajtohen me dispozitat e ligjit për shërbimin civil, për shkak të ndryshimit të regjimit juridik të marrëdhënies së tyre të punës, e cila trajtohet nëpërmjet Kodit të Punës.

Gjithashtu, edhe veprimi i institucionit për transferimin e përkohshëm të tij, nga pozicioni *Inspektor i Policisë Pyjore*, në pozicionin *Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor*, është konsideruar si veprim në kundërshtim me ligjin, pasi, është kryer nga organi jo kompetent, në këtë rast, titullari i institucionit, si dhe nga një pozicion pune që nuk është pjesë e shërbimit civil, (*Inspektor i Policisë Pyjore*), në një pozicion pune të shërbimit civil (*Inspektor në Sektorin e Mjedisit*).

Ndërkohë, nëpërmjet kërkesës së regjistruar nga punonjësi *****, me nr.381 prot., datë 27.3.2019, Komisioneri, u vu në dijeni të faktit se, ky punonjës, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me institucionin, pasi, me aktin nr. 99, datë 21.3.2019, të Kryeinspektorit, ai është liruar nga detyra. Për të kundërshtuar veprimet administrative të institucionit, punonjësi në fjalë, ka regjistruar çështjen pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, me nr. akti 2800, datë 13.5.2019.

Në këto kushte, nisur nga parimi i përcaktuar në nenin 36, paragrafi II dhe III, të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, *asnjë institucion nuk mund të trajtojë çështje të cilat janë duke u trajtuar nga sistemi gjyqësor*, Komisioneri nuk e trajtoi këtë rast në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, pasi do të marrë zgjidhje përfundimtare nga gjykata.

- në **2 raste**, nëpunësit kanë ardhur me procedurë të transferimit të përkohshëm, nga institucione të tjera të shërbimit civil.

Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

1. ***** , me aktin nr. 2608/1, datë 17.4.2018, të DAP, është transferuar përkohësisht, në pozicionin “*Specialist prokurimesh*”, në Drejtorinë Juridike, Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, pranë ISHMPUT, në qendër. Konstatohet se, kjo punonjëse, ka kryer detyrën “*Specialist në Sektorin e Ligjshmërisë dhe Statusit*”, në Institutin e Integritit të ish Përndjekurve Politikë.

2. *****, me aktin nr. 5278/1, datë 17.7.2018, të DAP, është transferuar përkohësisht, në pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor*”, pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Vlorë. Ky punonjës ka kryer detyrën *Doganier në Zyrën e Operacioneve Doganore*, Dega Doganore Vlorë.

Nga përmbajtja e akteve të mësipërme, rezulton se, në të dy rastet, transferimi i përkohshëm, është realizuar në zbatim të pikës 2/c, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, pasi, këta punonjës, janë transferuar përkohësisht në institucionin e mbikëqyrur nga institucione të tjera të shërbimit civil.

Në rastin e punonjësit *****, Komisioneri, u informua nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit se, me aktin nr.1230/1, datë 26.2.2019, të DAP, është bërë transferimi i përhershëm i tij në pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor*”, pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Vlorë. Ky veprim është kryer në bazë të përcaktimeve të nenit 49, shkronja “b” dhe nenit 52, të ligjit, për shkak të shmangies së konfliktit të interesit.

Në lidhje me punonjësën *****, në projektraportin e mbikëqyrjes, i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse DAP, që të shprehet për transferimin e përkohshëm të saj në pozicionin “*Specialist prokurimesh*”, në Drejtorinë Juridike, Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, pranë ISHMPUT, në qendër, pasi janë tejkaluar afatet kohore që përcakton ligji në lidhje me transferimin e përkohshëm (deri në 6 muaj gjatë 2 viteve).

Nisur nga observacionet e institucionit, si dhe nga aktet e dërguara, Komisioneri konstaton se, punonjësja *****, pas zhvillimit të procedurave të konkurrimit, me aktin nr. 3342, datë 3.6.2019, të DAP, është emëruar nëpunës civil, në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standarteve në Turizëm në ISHMPUT.

Konkluzion: Nga sa analizuam më sipër, vlerësohet se, procedura e transferimit të përkohshëm, është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 48, pika 2/c, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe të Vendimit nr.125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”.

b. Transferime për shkak të ristrukturimit të institucionit

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, u konstatua se, në vitin 2018, institucioni është përfshirë në proces ristrukturimi, si rezultat i ndryshimeve që ka sjellë miratimi i strukturës me Urdhrin e Kryeministrit nr. 120, datë 31.7.2018, “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit*”.

Nisur nga ky fakt, si dhe në zbatim të programit të mbikëqyrjes, grupi i punës, verifikoi respektimin e kërkesave që parashikon ligji nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në lidhje me procesin e ristrukturimit dhe procedurën e ndjekur në këtë rast.

Nga ky verifikim, rezulton se, siç e kemi thënë edhe në hyrje të materialit, struktura e re e miratuar, pasqyron ndryshimin e misionit të institucionit, të cilit i është shtuar funksioni i inspektimit të ujërave dhe ai i inspektimit për kundërvajtjet administrative në fushën e turizmit.

Në rastin konkret, në strukturë është shtuar Drejtoria e Inspektimit të Ujërave me sektorë në qendër dhe në degët rajonale, për shkak të shkrirjes së Inspektoratit të Ujërave, si dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standarteve në Turizëm, në kuadër të riorganizimit të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut.

Në këtë kuptim, procesi i ristrukturimit, në këtë institucion, në përmbajtje të tij, përbëhet nga të gjitha aktet administrative që ka realizuar njësia përgjegjëse gjatë implementimit të tij, në rastin konkret, aktet e krijimit dhe të funksionimit të Komisionit të Ristrukturimit; aktet e transferimit të nëpunësve që u është ristrukturuar pozicioni i punës; si dhe aktet e riemërimit të nëpunësve të mbetur pas ristrukturimit.

Ky proces, është realizuar nga Departamenti i Administratës Publike, si njësia përgjegjëse, në bashkëpunim me institucionin e mbikëqyrur, në përmbushje të kërkesave të nenit 50, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, si dhe Udhëzimit nr.1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”*.

Nga përmbajtja e dispozitave ligjore, rezulton se, njësia përgjegjëse, është struktura që krijon Komisionin e Ristrukturimit dhe pas propozimit të bërë prej këtij mekanizmi, ka detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për sistemimin e çdo nëpunësi civil në vendet e reja të krijuara, të ristrukturuara apo të mbetura si pasojë e ristrukturimit.

Në rastin konkret, titullari i institucionit, në cilësinë e nëpunësit më të lartë civil të institucionit, me aktin nr. 4046 prot., datë 6.8.2018, i ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike, nxjerrjen e aktit të krijimit të Komisionit të Ristrukturimit për arsye të ristrukturimit në këtë institucion.

Në përgjigje të kësaj shkrese, njësia përgjegjëse (DAP), me Urdhrin nr. 83, datë 23.8.2018, *“Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit”*, ka ngritur Komisionin e Ristrukturimit, i cili përbëhet nga një përfaqësues i Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e kryetarit, nga

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, anëtar, si nëpunësi më i lartë civil në institucionin nga i cili varet institucioni i mbikëqyrur, si dhe nga titullari i ISHMPUT, në cilësinë e nëpunësit më të lartë civil të institucionit që po ristrukturohet.

Komisioni i Ristrukturimit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pozicioneve të punës, duke u bazuar në përputhshmërinë e kriterëve të veçanta të pozicioneve të lira me të dhënat e nëpunësve të prekur nga ristrukturimi, me shkresën nr. 6770/48 prot., datë 21.9.2018, “*Vendim i Komisionit të Ristrukturimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë në kuadër të ristrukturimit*”, i ka propozuar njësisë përgjegjëse (DAP), transferimin në **111 raste**, të nëpunësve civilë në pozicione, të cilat janë riorganizuar për shkak të ristrukturimit, në Inspektoratin Qendër dhe në Degët Rajonale. Kjo kompetencë është e parashikuar në pikën 3, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, dhe në pikën 17, të Vendimit nr.125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”.

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, pasi ka marrë në shqyrtim propozimet e bëra nga Komisioni i Ristrukturimit, me shkresën nr. 6770/49 prot., datë 21.9.2018, ka vendosur transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë, vendet e të cilëve kanë pësuar ndryshime për shkak të ristrukturimit, për të gjitha rastet e propozuara.

Transferimi i nëpunësve civilë nga një pozicion në një tjetër pozicion pune në shërbimin civil, rezulton të jetë bërë *brenda së njëjtës kategori*, përveç dy rasteve, ku konstatohet ulje në detyrë e nëpunësve, me kërkesën e tyre.

Bëhet fjalë për nëpunësin *****, me detyrë “Drejtor”, i cili transferohet në pozicionin “Përgjegjës Sektor”, dhe nëpunësi *****, me detyrë “Kryeinspektor i Degës Rajonale”, i cili transferohet në pozicionin “Përgjegjës Sektor”.

Në rastin e uljes në detyrë të punonjësit, merret mendimi i tij me shkrim për pranimin, ose refuzimin e pozicionit të ofruar, siç përcaktohet në pikën 20 dhe 21, të Vendimit nr.125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”. Në rastin konkret, nëpërmjet kërkesës së tyre me shkrim, punonjësit kanë kërkuar transferimin në pozicionet si më sipër.

Konstatohet se, i gjithë ky proces, është kryer *brenda institucionit* të mbikëqyrur.

Nga verifikimi i mëtejshëm, konstatohet se, në **42 raste**, janë transferuar nëpunës të Inspektoratit Shtetëror të Ujërave për shkak të shkrirjes së tij dhe të kalimit të funksioneve pranë ISHMPUT, me aktin nr.6770/1 prot., datë 21.9.2018, të Departamentit të Administratës Publike.

Ndërsa, në **17 raste**, me aktin nr.6217/3 prot., datë 3.10.2018, të DAP, janë transferuar nëpunës të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, për shkak se, funksionet e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standarteve në Turizëm, kanë kaluar pranë ISHMPUT.

Këto transferime, janë bërë në zbatim të përcaktimeve të pikës 2/b, të nenit 50, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ku parashikohet, “*transferimi për shkak të ristrukturimit, në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi*”.

Vërejmë se, procesi i ristrukturimit, shoqërohet edhe me hartimin e përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil, sipas parashikimeve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, mbi bazën e të cilit kryhet risistemimi i punonjësve në të njëjtin pozicion apo transferimi i tyre. Detyrimin për hartimin e përshkrimeve të punës në momentin kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit, e parashikon edhe vendimi nr. 142, datë 12.3.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, i cili, në pikën 14, të kreut IV, parashikon: “Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit, apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni”.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, fillimisht ka përgatitur një ekstrakt me kërkesat e posaçme për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga ristrukturimi, por, siç e kemi thënë edhe më sipër në material, procesi i hartimit të përshkrimeve të punës në këtë institucion, akoma nuk ka përfunduar.

Nga verifikimi i dokumentacionit, nuk rezulton asnjë rast refuzimi në lidhje me vendimin e transferimit të nëpunësve, si rezultat i ristrukturimit, sikurse parashikohet në dispozitat ligjore. I gjithë procesi i ristrukturimit, është shoqëruar edhe me aktet e emërimit për çdo punonjës, sipas pozicionit të punës ku është transferuar për shkak të ristrukturimit.

Konkluzion: Nga sa analizuam më sipër, Komisioneri vlerëson se, procesi i ristrukturimit në institucionin e mbikëqyrur, është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, si dhe Udhëzimit nr.1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”.

VII.Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohshme emërimi, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në institucionin e mbikëqyrur, konstatohet se, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, drejtuesi i këtij institucioni, me aktin nr. 51, datë 27.2.2018, të Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit, është ngarkuar në ushtrimin e detyrave të Kryeinspektorit, pranë këtij inspektorati, ndërkohë që kryen detyrën Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve dhe Partneriteteve, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Nga përmbajtja e aktit, konstatohet se, ky emërim është bërë *me qëllim mbarëvajtjen dhe vijueshmërinë e punës në këtë institucion, deri në plotësimin e këtij pozicioni sipas procedurave ligjore.*

Në këtë rast, për plotësimin e këtij pozicioni pune, që i përket kategorisë së mesme drejtuese, neni 26, i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në pikën 1 dhe 3, të tij, parashikon plotësimin nëpërmjet *procedurës së lëvizjes paralele dhe në rast mosplotësimi, procedurën e ngritjes në detyrë.*

Më tej, nëse vendi i lirë, nuk plotësohet nëpërmjet procedurave si më sipër, në pikën 8, përcaktohet se, *nëse është e nevojshme, mund të zbatohet procedura e transferimit të përkohshëm në interes të institucionit, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 48, të ligjit për nëpunësin civil.* Referuar kësaj baze ligjore, si dhe pikës 2, të Kreut I, të Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, i cili ka dalë në bazë e në zbatim të ligjit, rezulton se:

“Nëpunësi civil, mund të transferohet përkohësisht, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, sipas rastit, përkatësisht brenda institucionit ku është emëruar,...., në një institucion të varësisë së institucionit ku është emëruar...”

a) Në interes të institucionit, deri në 6 (gjashtë) muaj me/ose pa ndërprerje, gjatë 2 viteve.

Më tej, në pikën 5 të po këtij kreu, përcaktohet:

“Transferimi i përkohshëm, në bazë të shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij vendimi, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila, njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet”.

Pra, nga sa më sipër, transferimi i një nëpunësi civil në një pozicion tjetër të shërbimit civil për nevoja të institucionit, miratohet nga njësia përgjegjëse (DAP) dhe nuk mund të zgjasë më shumë se 6 muaj në dy vite.

Nga këqyrja e akteve rezulton se, megjithëse akti ka dalë për nevoja të institucionit, ai nuk mund të konsiderohet si transferim i përkohshëm, pasi, nga njera anë, nuk rezulton që të jetë miratuar nga Departamenti i Administratës Publike, si njësia përgjegjëse dhe nga ana tjetër, nuk është

përcaktuar afati kohor i transferimit, i cili, edhe nëse do të ishte ndryshe, tashmë, ky afat është tejkaluar.

Për më tepër, akti i emërimit ka dalë nga ministri, ç'ka do të thotë se, akti ka dalë jo vetëm në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së tij, por edhe nga një organ jo kompetent, siç është institucioni i Ministrisë, i cili, si një pozicion politik, nuk mund të përfshihet në proceset e administrimit të shërbimit civil. Organi i vetëm kompetent për të vijuar procedurat e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, duke filluar që me momentin e emërimit, për institucionet e administratës shtetërore, është Departamenti i Administratës Publike.

Sa më sipër, akti i emërimit, i dalë nga ministri, është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, në vështrim të nenit 108, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, ku parashikohet shprehimisht se,

“Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:

a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:

i) kompetencën e organit publik;

ii) procedurën e nxjerrjes së tij;”.

Në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Në bazë të neneve 110, pika 2, 111 dhe 113, të ligjit si më sipër, vetë organi publik, në këtë rast Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, që ka nxjerrë aktin, duhet të anulojë këtë akt dhe të urdhërojë kthimin e nëpunësit në fjalë në vendin e punës. Vetëm pas këtij veprimi, mund të rinisë procedura, duke respektuar rregullat që u përmendën në pjesën e mësipërme të këtij materiali.

Konkluzion: Nga sa analizuam më sipër, për të rregulluar situatën e ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, në këtë rast, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, të konstatojë menjëherë, si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, aktin nr. 51, datë 27.2.2018, me anë të të cilit, nëpunësi *****, është ngarkuar për ushtrimin e detyrës si Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit dhe rikthimin e tij në pozicionin e mëparshëm të punës si Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve dhe Partneriteteve, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Në kushtet kur nga ana e institucionit pozicioni është shpallur i lirë, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, duhet të vijojë menjëherë procedurat për plotësimin e tij në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

VIII. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.

Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, konstatohet **1** rast pezullimi nga shërbimi civil për shkak të ligjit. Bëhet fjalë për nëpunësin *****, i konfirmuar nëpunës civil në pozicionin *Inspektor, në Sektorin e Inspektimit të Burimeve Natyrore, Drejtoria e Inspektimit Mjedisor në Inspektoratin Qendër*, i cili, është pezulluar nga shërbimi civil, për shkak se, Gjykata e Apelit Vlorë, ka vendosur si masë ndaluese pezullimin e ushtrimit të detyrës shtetërore (shkresa nr.183, datë 26.2.2018).

Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, sipas përcaktimeve të pikës 3, shkronja “a”, të nenit 54, të ligjit për nëpunësin civil, pasi ka marrë dijeni për shkakun e pezullimit, ka konstatuar ligjshmërinë e tij e në këto kushte, me aktin nr. 71, datë 6.3.2018, të Kryeinspektorit, është vendosur pezullimi i marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësin *****.

Ky vendim, sipas pikës 14, Kreu I, të Vendimit nr.124, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*”, i është bërë i ditur Departamentit të Administratës Publike, si njësi përgjegjëse.

Gjatë përgatitjes së këtij materiali, Komisioneri u vu në dijeni të faktit se, me aktin nr.167/1, datë 24.1.2019, Departamenti i Administratës Publike, në bazë të pikës 1, të nenit 56, të ligjit, si dhe të pikës 17, shkronja “a”, të aktit nënligjor si më sipër, e ka rikthyer nëpunësin *****, në pozicionin e mëparshëm të punës, pasi është zhdukur shkakun e pezullimit.

Konkluzion: Nga sa më sipër, vlerësohet se, njësi e burimeve njerëzore të institucionit, ka vepruar në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore në lidhje me pezullimin nga shërbimi civil të nëpunësit civil *****.

IX. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore.

Gjatë procesit të realizimit të mbikëqyrjes, u konstatua **1** rast, kur ndaj nëpunësit civil është marrë masa disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”. Në rastin konkret, bëhet fjalë për nëpunësin *****, me detyrë *Kryeinspektor* pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Berat, i konfirmuar “*nëpunës civil*” me aktin nr.2703, datë 2.9.2015, të Kryeinspektorit.

Me vendimin nr. 2, datë 5.4.2018, të Komisionit të Disiplinës, ndaj tij është marrë masa disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*” dhe me aktin nr. 123, datë 10.4.2018, të titullarit të institucionit, është urdhëruar përfundimi i marrëdhënies financiare.

Për këtë rast, u verifikua procedura e dhënies së masës disiplinore sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në Vendimin nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 2.4.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”. Nga këqyrja e akteve rezulton se, shkelja e konstatuar është konsideruar shkelje e rëndë disiplinore, dhe në këto kushte, në bazë të pikës 2, të nenit 59, të ligjit, procedimi disiplinor, është kryer nga Komisioni i Disiplinës, i cili ka kompetencën, për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore në këtë rast.

Komisioni i Disiplinës është ngritur me Urdhrin nr.29, datë 24.1.2018, të titullarit të institucionit, i cili, procedimin disiplinor, e ka filluar me kërkesë të eprorit direkt. Përbërja e Komisionit të Disiplinës, rezulton në përputhje me pikën 2, Kreu I, “Organet disiplinore”, të Vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”.

Konstatohet se, në bazë të pikës 6, të nenit 59, të ligjit për nëpunësin civil, me Urdhrin nr.59, datë 16.2.2018, fillimisht është vendosur pezullimi i punonjësit ***** nga ushtrimi i detyrës.

Komisioni i Disiplinës, ka filluar ecurinë disiplinore, duke njoftuar me shkrim nëpunësin për fillimin e ecurisë disiplinore si dhe për shkakun e nisjes së kësaj ecurie disiplinore; për të drejtën për të paraqitur me shkrim, sqarimet rreth shkeljes së pretenduar; për të drejtën për t’u dëgjuar vetë ose me përfaqësues; si dhe datën e shqyrtimit të shkeljes së pretenduar.

Këto akte u verifikuan nga grupi i mbikëqyrjes, duke përfshirë edhe deklaratat e anëtarëve të komisionit, që konfirmojnë se nuk kanë konflikt interesi; relacionin, ku parashtrihen shkeljet e pretenduara dhe rrethanat e shkeljes; si dhe procesverbalin e seancës dëgjimore të mbajtur për çdo rast shqyrtimi të shkeljes disiplinore, të nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të Disiplinës.

Evidentojmë faktin se, kjo ecuri disiplinore, është kryer në mungesë të nëpunësit, pas dy njoftimeve të njëpasnjëshme që i janë bërë atij për paraqitje në seancën e shqyrtimit të procedimit disiplinor, respektivisht me aktin nr. 939 prot., datë 7.3.2018 dhe me aktin nr.1260 prot., datë 28.3.2018.

Kjo procedurë, është parashikuar në pikën 16, Kreu II, “Procedura disiplinore”, e VKM nr.115, datë 5.3.2014, ku përcaktohet:

“Në rast se pas dy njoftimeve të njëpasnjëshme, nëpunësi apo përfaqësuesi i tij nuk paraqiten, ecuria disiplinore vazhdon në mungesë”, dhe më tej, në pikën 17:

“Organi disiplinor, pasi shqyrton çështjen.....apo vë në dukje me shkrim, mosparaqitjen e tij, megjithëse nëpunësi ka marrë dijeni rregullisht, vendos marrjen e masës disiplinore ose ndërprerjen e ecurisë disiplinore”.

Në përfundim të procedurës, Komisioni Disiplinor, ka marrë vendimin përkatës, për largimin nga shërbimi civil të punonjësit *****, duke arsyetuar shpjegimin e fakteve që janë bërë shkas për marrjen e vendimit. Konstatohet se, në bazë të së drejtës që i njeh nëpunësit civil neni 41, pika 3, e ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, kjo masë disiplinore, është ankumuar nga punonjësi dhe në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, çështja është në proces gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e shkeljes disiplinore, që nga momenti i konstatimit të shkeljes e deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga komisioni i disiplinës, rezulton të jetë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit dhe të akteve nënligjore, duke siguruar një proces të rregullt të hetimit administrativ dhe ushtrimin e të drejtës së nëpunësit civil për t`u dëgjuar dhe për t`u mbrojtur gjatë një procedimi disiplinor.

X. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar.

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, u verifikua procedura e ndjekur nga institucioni për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë për 6 mujorin e parë të vitit 2018, në përputhje me kërkesat e nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe Vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, ndryshuar me Vendimin nr. 252, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë””*.

Në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë të konfirmuar, është një proces që duhet të realizohet çdo 6 muaj, ndërsa për nëpunësit civilë në periudhë prove, periudha e vlerësimit është vjetore dhe llogaritet nga data e emërimit të tij.

Për realizimin e një vlerësimi sa më objektiv, në Vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, të ndryshuar, është përcaktuar dhe procedura që duhet të respektohet për procesin e vlerësimit të rezultateve në punë si dhe kompetencat për vlerësimin. Gjithashtu, pjesë e këtij vendimi, është edhe formulari i vlerësimit të punës, i miratuar për nëpunësit civilë.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, në institucionin e mbikëqyrur, për 6 mujorin e parë të vitit 2018, është bërë vlerësimi i rezultateve në punë vetëm për 28 nëpunës civilë, nga të cilët, 19 raste i përkasin Inspektoratit Qendër dhe 9 raste në Degën Rajonale Tiranë.

Përsa i përket formularëve të vlerësimit të punës për 11 Degët Rajonale, rezulton se, për shkak të parregullsive të konstatuara, ato u janë kthyer përsëri degëve, në mënyrë që të korrigojohen dhe të reflektohen parregullsitë. Konkretisht, procesi është konsideruar i parregullt, pasi, pothuajse në të gjitha degët rajonale, formularët e vlerësimit, nuk janë hartuar sipas formatit të miratuar në Lidhjen nr.2, pjesë e VKM nr. 109, datë 26.2.2014, si dhe për shkak të vlerësimit në nivelin 1, “shumë mirë”, për të gjithë punonjësit. Me anë të një e-maili, titullari i institucionit, u ka tërhequr vëmendjen degëve rajonale, duke e konsideruar të papranueshëm vlerësimin e rezultateve në punë, “shumë mirë”, të të gjithë punonjësve, në kushtet kur performanca e realizimit të detyrave prej tyre, nuk ishte në atë nivel. Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, ky proces, ka mbetur në këtë fazë dhe nuk është përfunduar.

Gjithashtu, mungojnë formularët e vlerësimit të punës edhe për punonjësit e Sektorit të Inspektimit të Ujërave (në qendër dhe në degët rajonale), si dhe për punonjësit e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standarteve në Turizëm, të cilët i janë bashkuar institucionit të mbikëqyrur në Shtator të vitit 2018, për shkak të riorganizimit të Inspektoratit të Ujërave dhe të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut.

Vemë në dukje se, sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i rëndësishëm, i cili i shërben verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit si dhe i aftësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave. Vlerësimi i performancës në punë ka pasoja të rëndësishme për një nëpunës civil dhe shërben për të marrë vendime objektive edhe në lidhje me periudhën e provës, ngritjen në detyrë, lirim nga shërbimi civil si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Formularët e vlerësimit duhet të plotësohen në të gjitha rubrikat e tyre, sipas kërkesave të aktit nënligjor që kanë të bëjnë me të dhënat personale (*ndarja A*); të dhënat për kontekstin e punës ku identifikohen objektivat e institucionit dhe të njësisë organizative ku bën pjesë nëpunësi (*ndarja B*); objektivat dhe matësit e performancës, ku duke mbajtur parasysh përshkrimin e punës, bëhet vlerësimi për çdo objektiv (*ndarja C*); sjellja profesionale, e cila ka të bëjë me saktësinë në punën e kryer dhe realizimin në kohë, punën në grup e marrëdhëniet me kolegët, shpeshtësinë e orëve të punës jashtë orarit, kërkesën për këshillim, trajnimin dhe ngritjen profesionale (*ndarja Ç*); vlerësimi përfundimtar i rezultateve në punë ku bëhet një vlerësim i përmbledhur i arritjes së objektivave kryesorë të punës nga nëpunësit. Në përfundim të procesit të vlerësimit, të nënshkruhen nga nëpunësit e përfshirë në të, të cilët janë, “Zyrtari Raportues”, “Zyrtari Kundërfirmues” dhe “Zyrtari Autorizues”.

Konkluzion: Komisioneri vëren se, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, në respektim të procedurave të hollësishme të parashikuara në Vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, dhe Lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, duhet të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për 6 mujorin e parë dhe të dytë, të vitit 2018, si dhe të ndjekë procesin për të respektuar afatet. Në përfundim të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, të përfshihet në Regjistrin Qendror të Personelit, formulari i vlerësimit për çdo nëpunës civil.

Sjellim në vëmendje të institucionit se, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë, synon të përmirësojë aftësitë profesionale të nëpunësve, si dhe të ndikojë në cilësinë e shërbimit të ofruar prej tyre. Për këtë arsye, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit, (*Zyrtari raportues/Zyrtari kundërfirmues/Zyrtari autorizues*), duhet të përfundojnë secilën periudhë të vlerësimit, brenda afateve të parashikuara në Vendimin nr. 109, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar.

Në rastin konkret, në pikën 12, shkronja “b”, të këtij vendimi, është parashikuar që, për 6 mujorin e parë të vitit, vlerësimi realizohet në periudhën 1-15 korrik dhe për 6 mujorin e dytë të vitit, në periudhën 1-15 janar. Më tej, në pikën 18, është përcaktuar se, *“Jo më vonë se 15 ditë nga data e përfundimit të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, njësia e burimeve njerëzore e institucionit detyrohet të përfshijë në Regjistrin Qendror të Personelit formularin e vlerësimit për çdo nëpunës civil”*.

Komisioneri konstaton se, nga ana e institucionit, në observacionet e parashtruara, pretendohet se, në lidhje me vlerësimet e rezultateve në punë për 6 mujorin e parë dhe të dytë, të vitit 2018, është përfunduar i gjithë procesi i vlerësimeve, por ky pretendim nuk provohet, pasi nuk ka akte shkresore, për të vërtetuar përfundimin e këtij procesi, sipas rekomandimeve të lëna në projektraport.

Për këtë arsye, Komisioneri çmon se verifikimi i përfundimit të procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë për 6 mujorin e parë dhe të dytë, të vitit 2018, sipas pretendimeve të institucionit, do të jetë objekt i verifikimit të mëtejshëm, në vijim të procesit të mbikëqyrjes në këtë institucion, lidhur me realizimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

XI. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil: si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.

Nga verifikimi i dokumentacionit që ka të bëjë me institutin e lirimit nga shërbimi civil, u konstatua se, për periudhën objekt mbikëqyrjeje, në institucionin e kontrolluar, në **22 raste**, ka përfunduar marrëdhënia e punës në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes, e cila, si një nga mënyrat e lirimit nga shërbimi civil, është e përcaktuar në nenin 64, pika 1 dhe nenin 66, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar.

Në këto dispozita ligjore përcaktohet se, *“Nëpunësi mund të njoftojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes me shkrim te njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku ushtron detyrën, ose DAP-it, në rastin e nëpunësit të TND-së”*.

Më tej, *“kur nëpunësi jep dorëheqjen, marrëdhënia në shërbimin civil përfundon nëpërmjet lirimimit nga shërbimi civil, i cili deklarohet me vendim të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën”*.

Në përfundim të kësaj procedure, në rastin e institucioneve të administratës shtetërore, vendimi i lirimimit nga shërbimi civil të nëpunësve të kategorisë ekzekutive, të ulët apo të mesme drejtuese, brenda 3 (tre) ditëve pune nga data e marrjes së vendimit, i njoftohet Departamentit të Administratës Publike, e parashikuar në pikën 21, Kreu III, *“Lirimi nga shërbimi civil”*, të Vendimit nr. 124, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil”*. Në rastin konkret, janë liruar nga shërbimi civil, si pasojë e dorëheqjes, nëpunësit si më poshtë:

1. *****, Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, liruar me aktin nr.300, datë 13.9.2017.
2. *****, Specialist Jurist, pranë ISHMPUT, qendër, liruar me aktin nr. 84, datë 12.4.2018.
3. *****, Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë ISHMPUT, qendër, liruar me aktin nr. 30, datë 25.1.2018.
4. *****, Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Tiranë, liruar me aktin nr. 95, datë 2.5.2017.
5. *****, Përgjegjës në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Tiranë, liruar me aktin nr. 260, datë 4.6.2018.
6. *****, Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Durrës, liruar me aktin nr. 177, datë 3.5.2018.
7. *****, Specialist Jurist, pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Berat, liruar me aktin nr. 305, datë 5.12.2017.
8. *****, Përgjegjës në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Dibër, liruar me aktin nr. 86, datë 13.3.2018.
9. *****, Kryeinspektor pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Dibër, liruar me aktin nr. 145, datë 24.8.2015.
10. *****, Specialist Jurist, pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë, liruar me aktin nr.280, datë 4.9.2017.

11. *****, Kryeinspektor pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Shkodër, liruar me aktin nr.183, datë 7.5.2018.
12. *****, Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Shkodër, liruar me aktin nr. 282, datë 30.11.2016.
13. *****, Specialist Jurist, pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Shkodër, liruar me aktin nr. 238, datë 25.5.2018.
14. *****, Kryeinspektor pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Kukës, liruar me aktin nr. 108, datë 16.5.2017.
15. *****, Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Korçë, liruar me aktin nr. 76, datë 12.4.2017.
16. *****, Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Korçë, liruar me aktin nr. 140, datë 3.7.2017.
17. *****, Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Korçë, liruar me aktin nr. 317, datë 12.12.2016.
18. *****, Specialist Finance, pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Korçë, liruar me aktin nr.61, datë 19.2.2018.
19. *****, Specialist Jurist, pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Lezhë, liruar me aktin nr. 25, datë 23.1.2018.
20. *****, Përgjegjës në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Elbasan, liruar me aktin nr. 232, datë 29.6.2016.
21. *****, Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Elbasan, liruar me aktin nr. 457, datë 10.12.2018.
22. *****, Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, pranë ISHMPUT, Dega Rajonale Elbasan, liruar me aktin nr. 77, datë 12.4.2017.

Konstatohet se, në të gjitha rastet, pas miratimit të dorëheqjes me shkrim, ka dalë akti i lirimit nga shërbimi civil, sipas përcaktimeve në aktet ligjore e nënligjore për lirimin nga shërbimi civil si pasojë e dorëheqjes.

Në rastin e nëpunësve civilë të dorëhequr, në nenin 64, pika 4, të ligjit 152/2013, të ndryshuar, parashikohet e drejta e tyre që të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji, deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil. Mbështetur në përcaktimet e kësaj dispozite, nëpunësit që në momentin e miratimit të dorëheqjes ishin konfirmuar “nëpunës civilë”, njësia përgjegjëse, që në rastin konkret është Departamenti i Administratës Publike, duhet t’i regjistrojë në një listë, me një afat qëndrimi deri në 2 vjet, i cili fillon nga data e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin

civil. Nisur nga kjo datë, bëhet fjalë për të gjithë ata punonjës, të cilët janë brenda këtij afati 2 vjeçar.

Konkluzion: Nga sa analizuam më sipër, Komisioneri vlerëson se, nga njësia e burimeve njerëzore, është vepruar në mbështetje të kërkesave të ligjit në lidhje me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes.

XII. Dosjet e personelit

a. Dosja e personelit

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, u këqyrën dosjet e personelit, për të verifikuar nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe kërkesave të Vendimit nr. 117, datë 5.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”.

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, u konstatua se në të, janë të përfshira dokumenta me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas lidhjes 1 dhe 2, bashkëlidhur aktit nënligjor, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt. Më konkretisht, rezultoi se, në dosjet personale të nëpunësve, administrohet dokumenti i identifikimit (*fotokopje e letërnyftimit*); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor dhe fushën e studimeve (*fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave*); dokumentet që vërtetojnë fillimin e marrëdhënieve të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*), si dhe aktet që provojnë procesin e deklaramit të statusit të punësimit.

Përsa i përket akteve që vërtetojnë gjendjen gjyqësore, rezulton se, në disa raste ato mungojnë, ndërsa, aktet që vërtetojnë gjendjen shëndetësore (*Raporti Mjekësor*), mungojnë pothuajse në shumicën e rasteve. Këto dy akte kanë të bëjnë me kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati për pranimin e tij në shërbimin civil, të parashikuara në shkronjën “ç” dhe “d”, të nenit 21, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Sjellim në vëmendje të institucionit se, vërtetimi i gjendjes shëndetësore, duhet të paraqitet pranë burimeve njerëzore të institucionit, brenda datës 10 janar të çdo viti, parashikuar në pikën 23, Kreu III, “*Lirimi nga shërbimi civil*”, të Vendimit nr. 124, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil*”.

Të gjitha dokumentet, duhet të pasqyrohen në fletë inventarin dhe në fletën prezantuese, të cilat përfshihen në dosjen teknike të nëpunësit, por, në shumicën e rasteve, fleta prezantuese mungonte ndërsa fleta e inventarit nuk i përgjigjej kërkesave të ligjit, sikurse përcaktohet në

lidhjen 1 dhe 2 të vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Nga të dhënat e administruara në dosjen e personelit, konstatohet se, në institucionin e mbikëqyrur, **40** nëpunës ose rreth **23 %** e nëpunësve, pjesë e shërbimit civil pranë këtij institucioni, janë femra dhe mosha mesatare e tyre është **35** vjeç; **134** nëpunës ose rreth **77 %** e tyre, janë meshkuj dhe mosha mesatare është **43** vjeç; ndërkohë që, mosha mesatare e nëpunësve civilë në këtë institucion është **39** vjeç.

Përsa i përket arsimit, konstatohet se, **145** nëpunës, kanë kryer arsimin e lartë në institucione arsimore publike; në **26** raste, nëpunësit e kanë kryer arsimin e lartë në institucion privat; në **3** raste, rezulton që, nëpunësit, kanë mbaruar arsimin e lartë në institucione arsimore jashtë Republikës së Shqipërisë. Diplomat janë të njehsuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, i cili është institucioni përgjegjës për njehsimin e diplomave.

Dosjet e personelit ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit.

Konkluzioni: Në lidhje me mangësitë e konstatuara, si dhe për të siguruar një administrim efikas të shërbimit civil, njësia e ngarkuar për menaxhimin e burimeve njerëzore në institucionin e mbikëqyrur, duhet të mbajë parasysh që:

- Të plotësojë të gjitha dosjet e nëpunësve me fletëinventarin dhe fletën prezantuese sipas lidhjes 1 dhe 2, bashkëlidhur vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” dhe të plotësohen ato me të gjitha të dhënat e kërkuara.
- Në fletën prezantuese të dosjes teknike të nëpunësit, në pikën që kërkohet “Përshkrimi i karrierës”, për të gjitha emërimet që nëpunësi ka patur në institucion të plotësohen në mënyrë kronologjike data e fillimit të marrëdhënieve juridike të punës dhe atyre financiare dhe emërtesa e pozicionit të punës, duke filluar nga momenti fillestar i emërimit e në vijim.
- Të administrohen në dosjen individuale të nëpunësit, të gjitha aktet e emërimit, që pasqyrojnë në mënyrë kronologjike lëvizjet e nëpunësit nga momenti i fillimit të marrëdhënieve juridike të punës dhe atyre financiare e në vijim, (aktet që pasqyrojnë ndryshim të pozicionit të punës, strukturim të pozicionit të punës, ndryshim të kategorisë së pozicionit të punës etj, ndryshime që lidhen me pozicionin e punës), si dhe aktet e evidentuara në mungesë në tabelën 2, e cila është pjesë e projektraportit.
- Përshkrimet e punës dhe vlerësimet e punës, të plotësuara dhe të nënshkruara nga nëpunësit kompetentë, (të formalizuara si çdo dokument tjetër zyrtar që krijohet nga institucioni), të administrohen në dosjen individuale të nëpunësit civil.

b. Regjistri i personelit

Regjistri Qendror i Personelit, si sistemi që ruan dhe përpunon të dhënat elektronike për burimet njerëzore aktive në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, në kuptim të ligjit, administrohet nga Departamenti i Administratës Publike.

Në rastin e institucionit të mbikëqyrur, rezulton se, ai ka akses në sistem dhe e ushtron këtë funksion nëpërmjet nëpunësit të autorizuar. Në sistem bëhet plotësimi dhe përditësimi i të dhënave të parashikuara në lidhjen 3, “Përkufizimi i administruesve dhe përdoruesve të sistemit”, që i bashkëlidhet Vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit të personelit”.

XIII. Të Tjera

➤ Emërim nëpërmjet lëvizjes paralele në një institucion tjetër të shërbimit civil

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, u konstatua se, në **1** rast, është vendosur përfundimi i marrëdhënieve financiare, për shkak të emërimit nëpërmjet lëvizjes paralele, në një institucion tjetër të shërbimit civil. Konkretisht, me aktin nr.2394, datë 10.4.2018, të DAP, punonjësja *****, e cila kryente detyrën *Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit*, pranë ISHMPUT, qendër, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, është emëruar në pozicionin *Përgjegjës i Sektorit të Partneritetit Publik Privat*, në Drejtorinë e Partneritetit Publik Privat në Fushën Energjitike, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Këto veprime janë kryer mbi bazën e nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

*

* *

Këto ish-in rrethanat e konstatuara nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej

momentit të fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Aktet administrative që dokumentojnë procesin e mbikëqyrjes në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, sipas pikave të këtij raporti, janë materializuar në tabelat si më poshtë:

Tabela 1 “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjësit që punojnë në pozicione pune të shërbimit civil, në momentin e mbikëqyrjes, në institucionin Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit”.

Tabela 2 “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe i kërkesave të posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në institucionin Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit”.

K O M I S I O N E R I

Pranvera STRAKOSHA

Punoi: A.Dobjani, Inspektor i mbikëqyrjes

Pranoi: A. Shumeli, Drejtor i Mbikëqyrjes

Miratoi: A. Basha, Drejtor i Përgjithshëm i Inspektimit dhe Mbikëqyrjes